



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.61

2006

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i Kuvendit nr.39, datë 29.5.2006	Për caktimin e një anëtari në Komisionin e Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore.....	1703
Vendim i Kuvendit nr.40, datë 29.5.2006	Për një ndryshim në vendimin nr.38, datë 18.5.2006 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore”.....	1703
Vendim i Kuvendit nr.41, datë 29.5.2006	Për një ndryshim në vendimin nr.35, datë 11.5.2006 “Për miratimin e përbërjes së Komisionit Hetimor “Për shkarkimet në administratën publike”.....	1704
Rezolutë e Kuvendit datë 25.5.2006	Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2005.....	1704
Rezolutë e Kuvendit datë 8.6.2006	Me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit.....	1706
Vendim i KM nr.343, datë 7.6.2006	Për pronësinë dhe administrimin e aeroportit të Kukësit.....	1707
Vendim i KM nr.344, datë 7.6.2006	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.459, datë 23.9.1999 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Komitetit Shtetëror për Kultet”, të ndryshuar, dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.....	1707

Udhëzim i ISSH nr.1, datë 11.5.2006	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.167, datë 29.3.2006 “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.....	1708
Vendim i GJK nr.16, datë 8.6.2006	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.531, datë 15.10.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si antikushtetues.....	1710
Vendim i AMS nr.13, datë 24.5. 2006	Për miratimin e shitjes së aksioneve të aksionarit Faik Bruci në masën 12 % të kapitalit themeltar te subjekti juridik EuroAlba EA sh.p.k.....	1713
Vendim i AMS nr.14, datë 24.5 2006	Për miratimin e blerjes së 10% të aksioneve të shoqërisë së sigurimeve Albsig sh.a. nga z.Faik Bruci.....	1714
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të vdekur të shtetasit Fatos Daneja.....	1714

VENDIM
Nr.39 datë 29.5.2006

**PËR CAKTIMIN E NJË ANËTARI NË KOMISIONIN E POSAÇËM PARLAMENTAR
PËR REFORMËN ZGJEDHORE**

Në mbështetje të nenit 77 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Deputeti Musa Ulqini caktohet anëtar në Komisionin e Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Fatos Beja

VENDIM
Nr.40, datë 29.5.2006

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.38, DATË 18.5.2006 “PËR NGRITJEN E
KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR REFORMËN ZGJEDHORE”**

Në mbështetje të nenit 77 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe Partisë Demokratike Sociale,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Deputeti Ndre Legisi caktohet anëtar në Komisionin e Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore në vend të deputetit Ilir Meta.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Fatos Beja

VENDIM
Nr.41, datë 29.5.2006

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.35, DATË 11.5.2006 “PËR MIRATIMIN E
PËRBËRJES SË KOMISIONIT HETIMOR “PËR SHKARKIMET NË ADMINISTRATËN
PUBLIKE”**

Në mbështetje të nenit 77 pika 2 të Kushtetutës dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit,
me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Deputetja Ermelinda Meksi caktohet anëtare në Komisionin Hetimor “Për shkarkimet në administratën publike” në vend të deputetit Besnik Dervishi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSKRYETARI
Fatos Beja**

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR
VITIN 2005**

Pasi u njoh me Raportin për Veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë për vitin 2005, bazuar në nenin 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit,

Kuvendi konstaton se:

Veprimtaria e Bankës së Shqipërisë është në përputhje me kërkesat e nenit 161 të Kushtetutës dhe me ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Kuvendi vlerëson veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, e cila, me politikën e saj monetare, ka ndikuar në:

- ruajtjen e stabilitetit ekonomik dhe financiar të vendit;
- ruajtjen e ritmeve të zhvillimit ekonomik e social të vendit, në përputhje me normat e parashikuara;
- mbajtjen e inflacionit brenda objektivit të parashikuar prej 2 deri në 4 për qind;
- forcimin e mëtejshëm të rezervës valutore me 4.6 muaj importe;
- forcimin e kapacitetit mbikëqyrës dhe kuadrit rregullator në fushën bankare;
- përmbushjen në mënyrë të kënaqshme të objektivave të ndërmjetëm të programit monetar, në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar nga autoritetet shqiptare me Fondin Monetar Ndërkombëtar;
- zgjerimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të sistemit bankar me operatorë të rinj në treg;
- zgjerimin e tregut të bonove të thesarit, si dhe emetimin e obligacioneve qeveritare me afat trevjeçar;
- zhvillimet pozitive në kreditimin e ekonomisë;
- forcimin e pavarësisë së Bankës së Shqipërisë.

Kuvendi inkurajon Bankën e Shqipërisë në nismat e saj për fuqizimin dhe qëndrueshmërinë e sistemit bankar shqiptar dhe rekomandon që, për vitin 2006, t’u kushtohet vëmendje:

- forcimit të pavarësisë së institucionit dhe thellimit të rolit mbikëqyrës dhe të garantuesit të sistemit bankar të vendit;
- rritjes së besueshmërisë së publikut ndaj Bankës së Shqipërisë dhe sistemit bankar në tërësi, duke zbatuar politika monetare efektive e transparente, si dhe standarde bashkëkohore në fushën e licencimit dhe të mbikëqyrjes bankare;
- rritjes së mëtejshme të bashkëpunimit me Qeverinë për harmonizimin e politikës monetare me ato të zhvillimit ekonomik e financiar të vendit dhe veçanërisht harmonizimin e këtij bashkëpunimi

për politikat fiskale;

- nxitjes së kreditimit të ekonomisë nëpërmjet sistemit bankar, veçanërisht të sektorëve prodhues dhe bujqësisë, duke synuar rritjen e nivelit të kreditimit të ekonomisë në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto dhe rritjen e kredisë në lekë. Rritja e kreditimit të ekonomisë të shoqërohet me masa monitoruese, të cilat garantojnë mbajtjen e normës së inflacionit nën kontroll;

- përmbushjes së angazhimeve për përafrimin e legjislacionit, sipas Planit Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit Vendas me atë të BE-së dhe zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Kuvendi i kërkon Bankës së Shqipërisë që të thellojë kontributin e saj në drejtim të:

- konsolidimit të mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik të vendit, duke iu përmbajtur angazhimeve të marra në marrëveshjen me Fondin Monetar Ndërkombëtar në janar 2006;

- ndjekjes me kujdes të politikës fiskale të Qeverisë, për të mos lejuar shkeljen e kufijve ligjorë të financimit të borxhit të brendshëm në mënyrë direkte nga Banka e Shqipërisë;

- përmbushjes së rolit të këshilltarit të Qeverisë, në lidhje me politikën monetare, si dhe politikat ekonomike dhe strategjitë e zhvillimit ekonomik dhe social;

- nxitjes e zhvillimit të mëtejshëm cilësor të sistemit bankar, për të mundësuar shërbime të reja për klientët dhe kosto më të ulët shërbimi. Zgjerimi i skemave, që synojnë reduktimin e pagesave cash jashtë sistemit bankar, të vazhdojë të mbetet përparësi e rëndësishme e punës së Bankës së Shqipërisë me të gjitha palët e interesuara;

- forcimit të mbikëqyrjes së bankave private, për të bërë që të gjitha zhvillimet në këtë sektor të jenë të sigurta dhe të mos sjellin tronditje në sistemin bankar;

- forcimit të mbikëqyrjes së bankave private në drejtim të uljes së kostos të shërbimeve bankare, me qëllim që ato të bëhen më atraktive ndaj të gjitha kategorive të klientëve e, në veçanti, biznesit;

- luftës ndaj pastrimit të parave dhe çeljes së llogarive anonime, të përcaktuara në nenet 287 dhe 287/a të Kodit Penal, si vepra që janë të lidhura me krimin e organizuar, për trafikimin e paligjshëm të njerëzve, mallrave dhe kapitaleve, me synim formalizimin e ekonomisë dhe krijimin e konkurrencës së lirë në treg;

- përmirësimit të legjislacionit në fushën e sistemit bankar për parandalimin e pastrimit të parave, legjislacionit mbështetës në fushën e kreditit, kolateralit dhe ekzekutimit të tij etj.;

- plotësimit të rekomandimeve të raportit të vlerësimit të sistemit financiar shqiptar, përgatitur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe që lidhen me sektorin bankar.

Kuvendi shpreh bindjen e tij se Banka e Shqipërisë edhe gjatë vitit 2006 do të vazhdojë të jetë një institucion i përgjegjshëm në fushën e hartimit dhe zbatimit të politikave monetare dhe të konsolidimit të mëtejshëm të sistemit financiar të vendit.

Tiranë, më 25.5.2006

REZOLUTË

ME RASTIN E NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT

Kuvendi i Shqipërisë përshëndet nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe vlerëson se ai përbën një moment historik në procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje shënon kurorëzimin e përpjekjeve disavjeçare në afrimin e Shqipërisë me Bashkimin Europian.

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson se nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit nis një fazë të re në marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Bashkimit European, për përgatitjen e vendit për anëtarësim të plotë në BE, gjithnjë në bashkëpunim të ngushtë me BE-në dhe në zbatim e respekt të plotë të kriterëve të Kopenhagenit dhe konkluzioneve të Samitit të Selanikut.

Kuvendi i Shqipërisë është i ndërgjegjshëm se zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është vendimtar dhe themelor për përparimin e mëtejshëm dhe përshpejtimin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin European. Kuvendi është i ndërgjegjshëm se në rrugën e reformave drejt integrimit të mëtejshëm nuk ka rrugë të shkurtra.

Kuvendi shpreh gatishmërinë dhe angazhimin e tij të plotë për të mbështetur përbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëdhënie e re institucionale me Bashkimin European, veçanërisht në drejtëm të forcimit të shtetit ligjor, të të drejtave të njeriut, të konsolidimit të ekonomisë së tregut, të luftës kundër korrupsionit e krimit të organizuar, në ruajtjen dhe forcimin e kapaciteteve administrative me realizimin e të gjitha reformave, të cilat sjellin rritjen e cilësisë së jetesës së qytetarëve. Një vëmendje dhe angazhim të veçantë Kuvendi i Shqipërisë do të tregojë për realizimin e reformës zgjedhore, me qëllim realizimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme dhe përfaqësimit e drejtë të vullnetit të qytetarëve. Nga ana tjetër, Kuvendi i kërkon BE-së dhe vendeve anëtare që, pas nënshkrimit dhe ratifikimit nga ana e Republikës së Shqipërisë të Marrëveshjes së Ripranimit dhe në përputhje me konkluzionet e Samitit të Selanikut, të vlerësojë masat për një liberalizim në rritje të lëvizjes së personave, si një aspiratë themelore e popullit shqiptar dhe si një tipar konceptual i integrimit europian.

Kuvendi i Shqipërisë shpreh vullnetin e tij për të mbështetur intensifikimin e bashkëpunimit me strukturat e Bashkimit European, në veçanti me vendet anëtare, Komisionin European dhe Parlamentin European. Kuvendi shpreh angazhimin e tij për një proces të shpejtë të ratifikimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit nga parlamentet e vendeve anëtare dhe për dhënien e pëlqimit nga Parlamenti European. Kuvendi i kërkon Qeverisë së Republikës së Shqipërisë hartimin e një axhende konkrete për etapat e mëtejshme në procesin e integrimit europian, përfshirë këtu edhe objektivat kohorë dhe cilësorë për marrjen e statusit të kandidatit.

Kuvendi i Shqipërisë shpreh dëshirën e tij që nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit të shërbejë si një nxitje e motivim i fuqishëm për vendet e rajonit në rrugën e tyre të integrimit europian dhe të shënojë në cilësi të re në marrëdhëniet midis vendeve tona. Kuvendi i Shqipërisë do të vijojë të mbështesë me vendosmëri politikën konstruktive të Republikës së Shqipërisë në rajon, duke synuar një rajon më stabil, më të integruar e me mirëqenie në rritje.

Kuvendi i kërkon Qeverisë së Republikës së Shqipërisë t'ia përcjellë këtë rezolutë vendeve anëtare të BE-së, Parlamentit European dhe Komisionit European.

Tiranë, më 8.6.2006

VENDIM

Nr.343, datë 7.6.2006

PËR PRONËSINË DHE ADMINISTRIMIN E AEROPORTIT TË KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 68, të ligjit nr.7877, datë 30.11.1994 “Për aviacionin civil” dhe të neneve 3,6,13 e 14 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Aeroporti i Kukësit është pronë e paluajtshme e shtetit, me statusin e pronës së paluajtshme publike.
 2. Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil është organi përgjegjës për administrimin e këtij aeroporti.
 3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.344, datë 7.6.2006

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.459, DATË 23.9.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KOMITETIT SHETETËROR PËR KULTET”, TË NDRYSHUAR, DHE PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2006, MIRATUAR PËR MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, të neneve 124 e 128, të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.459, datë 23.9.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Paragrafi i parë i pikës 3, ndryshohet si më poshtë vijon:
“Komiteti Shtetëror për Kultet përbëhet nga kryetari dhe 5 anëtarë. Kryetari i Komitetit Shtetëror për Kultet propozohet nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe emërohet nga Kryeministri, ndërsa anëtarët e këtij komiteti propozohen nga kryetari dhe emërohen nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Emërimi i përbërjes së këtij komiteti bëhet në mbështetje të parimeve të asnjësisë shtetërore dhe barazisë së bashkësive fetare, për të reflektuar identitetin dhe vlerat e bashkësive fetare.”.

2. Në fund të pikës 5 të shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:
“Numrit të përgjithshëm të punonjësve buxhetorë të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve i shtohet edhe një vetë. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, në titullin 086, t’i shtohet fondi prej 446 220 (katërqind e dyzet e gjashtë mijë e dyqind e njëzet) lekësh, për përballimin e pagës së anëtarit shtesë. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.1, datë 11.5.2006

**PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.167, DATË 29.3.2006
“PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJIT NR.7703, DATË 11.5.1993 “PËR
SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR, DHE
TË LIGJIT NR.7870, DATË 13.10.1994 “PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”**

Bazuar në nenin 75 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe në mbështetje të kreut VIII, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.167, datë 29.3.2006 “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore nxjerr këtë udhëzim:

1. Në kuptim të pikës 4, kreu I, nuk janë të detyruar të paguajnë kontribute personat me shtetësi të huaj ose pa shtetësi:

a) kur janë ortakë apo aksionarë në një subjekt juridik apo fizik të regjistruar dhe që zhvillon aktivitet ekonomik në territorin shqiptar, kur këta persona nuk punojnë vetë, por përfitojnë të ardhura nga pronësia apo aksionet në këto shoqëri;

b) kur punojnë në subjekte që zhvillojnë aktivitet ekonomik ose shoqëror mbi bazën e një kontrate pune me punëdhënës një subjekt jashtë vendit, nuk paguhen nga subjekti juridik që zhvillon aktivitet në Shqipëri, me listë pagese mujore, por të ardhurat e realizuara prej tyre i xhirohen subjektit të huaj sipas një kontrate paraprake.

2. Në zbatim të pikës 2, kreu V, të vetëpunësuarit në bujqësi i paguajnë kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore, individualisht, një herë në tre muaj. Në rast të mospagimit të kontributit të detyrueshëm në çdo tremujor, llogaritet kamatëvonesa, sipas nenit 16 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

a) Detyrimi ndaj fondit të sigurimeve shoqërore, përbëhet nga kontributi i papaguar në afatet e përcaktuara dhe kamatëvonesa e llogaritur.

b) Detyrimi kontributiv dhe kamatëvonesa e llogaritur evidentohen në regjistrin themeltar të të vetëpunësuarit në bujqësi, në momentin e krijimit të ndara nga njëra-tjetra dhe në kolonat përkatëse “diferenca e kontributit”, “kamatëvonesa e llogaritur”.

c) Në rastet kur kontributet vazhdojnë të mospaguhen, kamatëvonesat vazhdojnë të llogariten, duke u evidentuar në regjistrin themeltar, kolona “kamatëvonesa e llogaritur”.

d) Dokumenti bazë për evidentimin e detyrimit është aktdetyrimi tip, i cili hartohet nga inspektorët përgjegjës të sigurimeve shoqërore jo më vonë se një muaj nga kalimi i afatit ligjor për pagesën e kontributeve. Aktdetyrimi hartohet në dy kopje nga të cilat një kopje mbahet si dokument në Agjencitë e Sigurimeve Shoqërore, ndërsa kopja tjetër i dërgohet personit të vetëpunësuar për njoftim dhe për të realizuar pagesën. Shuma e detyrimeve kontributive të papaguara dhe e kamatëvonesave të llogaritura progresivisht për çdo muaj do të evidentohen në kontabilitet. Për këtë arsye çdo inspektor, për zonën që mbulon vetë dhe për zonat që mbulojnë agjentët e sigurimit të të vetëpunësuarve në bujqësi, për kontributet dhe kamatëvonesat e papaguara në vitin 2006, çdo tremujor deri në datën 10 të muajit pasardhës të tremujorit që do të ndërtojë një evidencë progresive (sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi), me këto të dhëna:

- Detyrime të shtuara gjatë periudhës: a) Kontribute. b) Kamatëvonesa.

- Detyrime të pakësuara gjatë periudhës: a) Kontribute. b) Kamatëvonesa.

- Gjendja e detyrimeve në fund të periudhës: a) Kontribute. b) Kamatëvonesa.

e) Gjendja e kontributeve dhe kamatëvonesave të papaguara në fund të periudhës e evidentuar sipas pasqyrës së mësipërme dhe e nënshkruar nga inspektorët përgjegjës dhe kryetari i degës së kontributeve, do të regjistrohet në kontabilitet duke debituar llogarinë “Debitorë të tjerë” dhe duke kredituar llogarinë “të ardhurat për t’u marrë”. Për detyrimet e paguara do të kreditohen llogaritë e të ardhurave duke debituar llogaritë bankare ndërkohë në të njëjtin moment do të bëhet edhe çregjistrimi i shumës së paguar në llogaritë e sipërshënuara.

3. Gjatë zbatimit të pikës 2, kreu IV, Agjencitë e Sigurimeve Shoqërore të bëjnë kujdes që për të njëjtnë tokë të mos bëhen dy sigurime, edhe ish-pronari edhe blerësi apo qiramarrësi.

4. Në zbatim të pikës 3, kreu V, likuidimi i detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore, gëzon përparësi në raport me detyrimet fiskale, përfshi taksën mbi tokën dhe borxhet. Organet e sigurimeve

shoqërore do të bashkëpunojnë me organet e pushtetit vendor, që të vetëpunësuarit në bujqësi, të detyrohen të paguajnë shumën e kontributeve të prapambetura, para detyrimeve të tjera, si p.sh. taksa mbi tokën.

5. Në zbatim të pikës 2, kreu VI, duke filluar nga data 1.6.2006, kështu mujore të përfitimit do t'i likuidohen përfituesit, në shuma të plota 100 lekëshe. Për këtë ISSH lidh marrëveshje shtesë me Postën Shqiptare sh.a., ku parashikohet që:

- Qendrat e pagesës së pensioneve të Postës Shqiptare sh.a., duke filluar nga data 1.6.2006, do të kryejnë pagesën e pensioneve mujore në bazë të shumës së shënuar në urdhërpagesë, në rreshtin "totali i të ardhurave mujore (I+II)", duke i kthyer në zero dy numrat e fundit të asaj shume.

- Për efekt të hartimit dhe kuadrimin të kolonave, me totalin e të ardhurave mujore të pensionistit, të evidentura në listëpagesën e përfitimeve, shuma (tepricë) që rezulton nga kthimi në zero i dy numrave të fundit, të totalit, i zbritet pensionit mujor, ndërsa shuma e "shtesave të tjera", shënohet siç është në urdhërpagesë.

- Shuma e të ardhurave mujore të pensionistit, e pakësuar si pasojë e pagesës së përfitimeve në shumë të plotë, do të paguhet njëherësh për 12 muaj, në muajin qershor të çdo viti. Shumat e pakësuara për çdo muaj, do të mbliidhen për 12 muaj të periudhës qershor-maj, të vitit pasardhës dhe do të evidentohen për çdo pensionist, në një urdhërpagesë të listuar. Urdhërpagesa hartohet nga Agjencia e Sigurimeve Shoqërore dhe qendra paguese, nënshkruhet nga personat e autorizuar të organeve të sigurimeve shoqërore, vendoset vula, dhe shërben si akt që autorizon pagesën e totalit të pjesës së pensioneve, të papaguara gjatë muajve.

- Mbi bazën e urdhërpagesës së listuar, qendrat e pagesës së pensioneve hartojnë listëpagesën e diferencave sipas paraqitjes dhe në momentin e që u paguhen pensionistëve. Shumat e paguara do të njihen në kontabilitet dhe financohen si shpenzim i muajit, kur kryhet pagesa. Mbi këto shuma llogaritet edhe komisioni sipas koeficientit të përcaktuar.

- Në rast kur urdhërpagesa mbyllet (për arsye transferimi, vdes pensionisti etj.), pas njoftimit zyrtar të mbylljes së urdhër pagesës dhe arkivimit të saj, qendra paguese njofton për shumën e diferencave mujore të pensionit të papaguar për shkak të veprimeve të sipërshënuara. Këto shuma, evidentohen në urdhërpagesë të veçantë, e i paguhen personit të autorizuar, konform dispozitave ligjore të përcaktuara për këtë qëllim.

- Në rastet kur pensioni mujor nuk tërhiqet rregullisht çdo muaj, shuma e përfitimeve mujore u paguhet e plotë, sipas totalit të shumave mujore të shënuara në urdhërpagesë, për të gjitha kështu e papagura deri në fund të muajit maj, pararendës. Shumat e muajve në vazhdim do të paguhen në shifër të plotë 100 lekëshe, duke bërë zero dy numrat e fundit të totalit sipas rregullit të përcaktuar më lart. Pagesa e tyre, si edhe për rastet e tjera do të bëhet në qershorin e ardhshëm dhe do të jetë e barabartë me shumën e pensionit të pakësuar për çdo muaj.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Koço Barka

VENDIM
Nr.16, datë 8.6.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 21.03.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.23 Akti që i përket:

KËRKUESI: SHPËTIM NGJELINA, përfaqësuar nga avokati Maksim Haxhia, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.531, datë 15.10.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31/c, 33/1, 42, 131/f, 134/g të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të mësipërm:

- Gjykimi në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë është zhvilluar pa pjesëmarrjen e avokatëve, gjë që ka sjellë mohimin e së drejtës kushtetuese për t'u mbrojtur, parashikuar në nenin 31/c të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë;

- Mungesa e mbrojtjes, ka ndikuar drejtpërsëdrejti në objektivitetin e gjykimit të zhvilluar në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Xhezair Zaganjori, përfaqësuesin e kërkuesit dhe shqyrtoi çështjen në tërësi;

VËREN:

Me vendimin nr.15, datë 3.02.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, kërkuesi është deklaruar fajtor për veprat penale të "Armëmbajtjes pa leje" e "Prodhimit, shitjes dhe mbajtjes së narkotikëve", dhe në bazë të neneve 278/2, 283/1 dhe 55 të Kodit Penal, është dënuar me 6 vjet burgim.

Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr.31, datë 26.03.2003 ka vendosur prishjen e vendimit të mësipërm, pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Shpëtim Ngjelina dhe lirin e tij të menjëhershëm nga paraburgimi.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.531, datë 15.10.2003 ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Në këtë gjykim, rezulton të mos ketë marrë pjesë as i pandehuri dhe as mbrojtësi i tij, por vetëm prokurori, i cili kishte paraqitur edhe rekursin kundër vendimit të dhënë nga gjykata e apelit. Megjithatë, në dosje ndodhet një dëftesë e komunikimit të rekursit drejtuar Gjykatës së Lartë, e cila është nënshkruar nga vëllai i të gjykuarit Shpëtim Ngjelina.

Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, pretendohet se në gjykimin e zhvilluar në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë është cenuar rëndë e drejta për proces të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues, prandaj vendimi i marrë prej asaj gjykate duhet të shfuqizohet si antikushtetues. Sipas kërkuesit, parregullsia e procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë qëndron kryesisht në mohimin e së drejtës së mbrojtjes, duke mos iu dhënë mundësia të përfaqësohet me ndihmën e një mbrojtësi ligjor. Ai thekson se një gjë e tillë, është rrjedhojë e mosdijenisë së tij për rekursin dhe ditën e gjykimit të çështjes në këtë gjykatë.

Duke pasur parasysh materialet e dosjes gjyqësore, si dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese në zbatim të standardeve të procesit të rregullt ligjor në kuptim të neneve 42 dhe 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, vlerësohet se pretendimi i kërkuesit është i drejtë.

Gjykata Kushtetuese thekson se veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe lidhur ngushtë me këto, mbrojtja e të pandehurit, garantuar shprehimisht në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj, për respektimin e këtyre parimeve, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, mes të cilave, sipas rastit, rëndësi të veçantë paraqet edhe njoftimi i të pandehurit apo mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes etj. Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të

drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij. Është detyrë e shtetit që të marrë masat e duhura për të garantuar pjesëmarrjen në procesin penal të personit të akuzuar ose mbrojtësit ligjor, qoftë edhe atij të caktuar kryesisht.

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ka theksuar disa herë se kërkesat e mësipërme duhet të respektohen jo vetëm në shkallën e parë, por edhe në shkallët e tjera të gjykit, veçanërisht në rastet kur në këto gjykime parashikohet edhe zhvillimi i debatit me gojë.¹

Mbi këtë bazë, Gjykata Kushtetuese konfirmon që në gjykimet penale të shkallës së parë dhe në apel, pra aty ku çështja shqyrtohet në fakt dhe në ligj, pjesëmarrja e të pandehurit ose e mbrojtësit ligjor të tij është në çdo rast e detyrueshme. Mungesa e të pandehurit apo avokatit të tij, do të çonte sipas rastit në shtyrjen e seancës gjyqësore ose në caktimin e një mbrojtësi kryesisht.²

Respektimi i këtyre standardeve në gjykimin që zhvillon Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk mund të jetë gjithnjë i njëjtë. Padyshim që këtu merren në konsideratë veçoritë dhe natyra e gjykit në Gjykatën e Lartë, shqyrtimi i së cilës përqendrohet kryesisht në çështje ligjore, në mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga gjykatat e nivelit më të ulët. Pikërisht për këtë arsye, realizimi i mbrojtjes së personit të akuzuar në seancën gjyqësore që mund të zhvillohet në këtë gjykatë bëhet vetëm nga mbrojtësi ligjor i tij. Një mbrojtje e tillë është në interes të të pandehurit dhe të dhënies së drejtësisë në përgjithësi, për të cilën një rol tepër të veçantë Kushtetuta i ngarkon pikërisht Gjykatës së Lartë.³ Prandaj edhe në këtë rast, në funksion të garantimit të kësaj mbrojtjeje, sipas Kodit të Procedurës Penale, ndër të tjera duhet të bëhet njoftimi i palëve, me qëllim që personit të akuzuar të mund t'i realizohet një mbrojtje sa më efektive dhe në këtë shkallë gjykimi.

Në ndryshim nga gjykimi që zhvillohet në shkallën e parë dhe në apel, mospjesëmarrja e mbrojtësit të të gjykuarit në Gjykatën e Lartë edhe pas bërjes së rregullt të njoftimeve respektive, nuk do të përbënte gjithnjë proces të parregullt në kuptimin kushtetues. Por, nëse “interesat e drejtësisë” do ta kërkonin një gjë të tillë, atëherë mbrojtja e personit të akuzuar, qoftë edhe kryesisht, në kuptim të nenit 6/3c të Konventës, do të ishte mëse e nevojshme edhe në këtë shkallë të gjykit.⁴ Në këtë kuptim, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ka vënë në dukje se në funksion të mbrojtjes së të pandehurit, kur vlerësohet se ekziston interesi i drejtësisë në kuptim të nenit 6/3 shkronja “c” të Konventës, gjykata nuk mund të mjaftohet të ofrojë ndihmë ligjore vetëm nëse personi i akuzuar nuk ka mjete të mjaftueshme financiare për një gjë të tillë, por edhe ta caktojë atë vetë kryesisht, “...sepse avokati zyrtar mund të vdesë, të sëmuret rëndë, të ketë një problem tjetër ose t'i shmanget detyrës. Në rast se autoritetet vihen në dijeni për këtë, ato duhet ta zëvendësojnë, ose ta detyrojnë të kryejë detyrën ... Të bësh interpretim kufizues..., do të thotë të arrish në rezultate të paarsyeshme, të papajtueshme me atë që thotë shkronja “c” si dhe me logjikën e nenit 6 në tërësi; pra ndihma juridike ... rrezikon të mbetet një fjalë boshe.”⁵

Vlerësimi, nëse ndodhemi para interesit të drejtësisë ose jo në gjykimin që do të zhvillohet në Gjykatën e Lartë, varet sipas rastit nga natyra e çështjes, nga subjekti që ka paraqitur rekursin dhe kompleksiteti apo vështirësia e problemeve ligjore të parashtruara në të, nga lloji dhe masa e dënimit që rrezikon të jepet ndaj të akuzuarit në krahasim me vendimet e dhëna nga gjykatat më të ulëta, etj. Ajo varet gjithashtu edhe nga vendi, roli dhe detyrat që kryen një gjykatë e tillë në çdo vend të veçantë. Në këtë kuadër, theksohet se ndihma ligjore është veçanërisht e rëndësishme në vendet ku e drejta e aksesit në këto gjykata mund të realizohet vetëm nëpërmjet avokatit mbrojtës⁶ ose legjislacioni procedural respektiv nuk parashikon mundësinë e kundërrekursit nga ana e palës kundërshtare.

Përsa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se interesat e drejtësisë kërkojnë detyrimisht

¹ Shih ndër të tjera çështjen Alimena kundër Italisë, në A.195-D, dt.19.02.1991, cituar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19/2003.

² Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.33/2003.

³ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.25/2003.

⁴ Shih Pakelli kundër Gjermanisë në “Për një rend publik Europian”, Tiranë 2001, fq.816.

⁵ Shih Artico kundër Italisë në “Për një rend publik Europian”, Tiranë 2001, fq.805. Pikërisht mbi këtë bazë konkludohet se z.Artico nuk i ishte siguruar mbrojtje efektive në Gjykatën e Kasacionit, gjë që kishte dëmtuar realisht të akuzuarin.

⁶ Shih RD kundër Polonisë, Vendimi datë 18.03.2002, paragrafi 50,51.

realizimin e mbrojtjes, qoftë edhe me avokat të caktuar kryesisht, të të akuzuarit që gjykohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori, në të cilin, ndër të tjera, kërkohet një rëndim i dukshëm i pozitës së tij, në krahasim me vendimin e dhënë për këtë çështje nga gjykata e apelit.⁷

Në rastin në shqyrtim, kërkuesit një e drejtë e tillë nuk i është garantuar në Gjykatën e Lartë. Gjykata e apelit ka vendosur pushimin e çështjes dhe lirimin e tij të menjëhershëm nga paraburgimi. Në gjykimin që ka zhvilluar pas rreth 7 muajsh Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mbi bazën e rekursit të prokurorit, nuk ka marrë pjesë as i pandehuri dhe as mbrojtësi i tij. Ky kolegji praktikisht ka vlerësuar vetëm pretendimet e prokurorit të paraqitura në rekurs dhe në seancë, në të cilat është kërkuar deklarimi fajtor dhe dënimi me burgim i të pandehurit. Pala e akuzuar, konkretisht mbrojtja e saj, nuk ka pasur mundësi të shprehet për asnjë nga këto pretendime. Në këto kushte, qartazi, nuk është respektuar parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, e për pasojë është cenuar rëndë e drejta e mbrojtjes së kërkuesit.

Gjykata Kushtetuese çmon se përputhja me kërkesat e procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues, të garantuara në nenet 31/1, 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhej të kishte verifikuar arsyet e mosparaqitjes dhe më pas, në funksion të këtij verifikimi, duhej të kishte vendosur shtyrjen e seancës gjyqësore ose edhe mbrojtjen e kërkuesit me avokat të caktuar kryesisht.

Pretendimi tjetër i kërkuesit për mungesë të objektivitetit në shqyrtimin e çështjes nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk mund të analizohet hollësisht, pasi vetë kërkuesi e arsyeton këtë si pasojë e cenimit të së drejtës së mbrojtjes në gjykim, gjë që pranohet nga ana e kësaj gjykate.

Si përfundim, Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin se procesi në ngarkim të kërkuesit i zhvilluar në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, ka qenë i parregullt në këndvështrimin kushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131 shkronja “f” dhe 134/1 shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.531, datë 15.10.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.13, datë 24.5. 2006

PËR MIRATIMIN E SHITJES SË AKSIONEVE TË AKSIONERIT FAIK BRUCI NË MASËN 12 % TË KAPITALIT THEMELTAR TEK SUBJEKTI JURIDIK EUROALBA EA SHPK

Në mbështetje të neneve 55 dhe 56 dhe të pikës 2 të nenit 57 të ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimeve, risigurimeve dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime” dhe shkronjës “f” të nenit 6 dhe të shkronjës “k” të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr. 9268, datë 29.07.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve”, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

⁷ Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.21, dt.20.09.2005; nr.23, dt.13.10.2005 dhe nr.24, dt.26.10.2005.

VENDOSI:

1. Të miratojë pjesëmarrjen influencuese të aksionarit të shoqërisë së sigurimit “Eurosig” sh.a. si më poshtë:

a) Personi juridik “EuroAlba EA” sh.p.k. me përfaqësues z.Gazmend Neza aksionar me pjesëmarrje prej 12 % (për qind) të aksioneve në shoqërinë e sigurimeve Euros sig sh.a.

b) Miratimi i pjesëmarrjes bëhet me kushtin që të realizohet faktikisht shitja e aksioneve që zotëron shoqëria EuroAlba EA sh.p.k. në Bankën Popullore sh.a. tek zoti Alfred Gjata në masën prej 2.08 % që i korrespondon vlerës jo më pak se 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë dhe kjo shitje të dokumentohet me akt noterial.

2. Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve rezervon të drejtën e revokimit të miratimit të pikës 1 të këtij vendimi në rast se më vonë do të rezultojë se:

a) është dhënë mbi bazën e informacionit të pasaktë ose të rremë;

b) rrezikon veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit sipas parashikimeve të kreut VI të ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004.

Ky vendim hyn në fuqi 24.05.2006.

**ANËTARI I KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Shpëtim Shehu**

**VENDIM
Nr.14, datë 24.5 2006**

**PËR MIRATIMIN E BLERJES SË 10% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË SË
SIGURIMEVE ALBSIG SHA NGA Z.FAIK BRUCI**

Në mbështetje të neneve 55 dhe 56 dhe të pikës 2 të nenit 57 të ligjit nr.9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimeve, risigurimeve dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime” dhe shkronjës “f” të nenit 6 dhe të shkronjës “k” të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr. 9268, datë 29.07.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve”, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Të miratojë pjesëmarrjen influencuese të aksionarit të shoqërisë së sigurimit “Albsig” sh.a. nëpërmjet blerjes së aksioneve të reja të emetuara si më poshtë:

a) Z. Faik Bruci aksionar me pjesëmarrje prej 10 % (dhjetë për qind) të aksioneve në shoqërinë e sigurimeve Albsig sh.a.

2. Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve rezervon të drejtën e revokimit të miratimit të pikës 1 të këtij vendimi në rast se më vonë do të rezultojë:

a) është dhënë mbi bazën e informacionit të pasaktë ose të rremë;

b) rrezikon veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit sipas parashikimeve të kreut VI të ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004.

Ky vendim hyn në fuqi 24.5.2006.

**ANËTARI I KËSHILLIT TË AUTORITETIT
MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Shpëtim Shehu**

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gramsh me vendimin nr.84, datë 17.5.2006 shpalli të vdekur shtetasin Fatos Daneja.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

Hyri në shtyp më 13.6.2006
Doli nga shtypi më 15.6.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2006

Çmimi 100 lekë